# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2024 – Numri: 45

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E martë, 12 mars 2024**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 18/2024, datë 15.2.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar...................................... | 4831 |
| Dekret i Presidentit nr. 99, datë 7.3.2024 | Për shpallje ligji........................................................................................ | 4843 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 6.3.2024 | Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara...................................................... | 4844 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 339, datë 1.6.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për sistemimin me mjedise pune të disa institucioneve shtetërore dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes'", të ndryshuar......... | 4874 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 6.3.2024 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, të pasurisë me nr. 7/120 dhe të një pjese të pasurisë me nr. 7/466, zona kadastrale 8270, Tiranë........................... | 4876 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 6.3.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 364, datë 11.6.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës"............................................................................ | 4878 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 6.3.2024 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 620, datë 1.11.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës"............................................ | 4884 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 6.3.2024 | Për miratimin e marrëveshjes së zbatimit nr. II, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe *Deutsche Gesellschaft Für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GMBH*, si përfaqësuese e qeverisë gjermane, në lidhje me programin "Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt konsumatorit dhe performancës" (*CPWS*)........................................................................ | 4884 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 6.3.2024 | Për miratimin e marrëveshjes shtesë të marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (marrësi) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) (Agjencia e zbatimit të projektit) dhe *KfW Frankfurt am Main (KfW),* për programin e rindërtimit të ndërtesave publike (faza I), miratuar me vendimin nr. 1150, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave..... | 4889 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 6.3.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar....... | 4890 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 6.3.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 823, datë 19.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksioni i linjës 400 kV Shqipëri–Maqedoni e Veriut'"................................................................ | 4892 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 6.3.2024 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion dhe ndërtim i rrugëve 'Ksanthipi Zyko' dhe 'Abdyl Ypi', Bashkia Durrës"................................................................................ | 4893 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 6.3.2024 | Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës......................................................................................... | 4896 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 6.3.2024 | Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar....................................... | 4897 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 6.3.2024 | Për një shtesë në vendimin nr. 173, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare", të ndryshuar.................................................................. | 4902 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 6.3.2024 | Për një ndryshim në vendimin nr. 169, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar........................................................................................... | 4902 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 6.3.2024 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i asociuar' dhe 'Profesor'", të ndryshuar........................................................................................... | 4902 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 6.3.2024 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar"........................................................................... | 4907 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 6.3.2024 | Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë e Zhvillimin Rural, për vitin 2024............................................................. | 4908 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 6.3.2024 | Për dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "Klais" sh.p.k....................................... | 4911 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 6.3.2024 | Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve....................................................................... | 4911 |
| Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 698 (4654), datë 31.10.2023 | Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Emilian Kaloshi....... | 4913 |

**LIGJ**
**Nr. 18/2024**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 155/2015 "PËR LOJËRAT E FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në ligj fjalët "baste sportive" zëvendësohen me fjalët "baste sportive *online*" dhe fjalët "banka të nivelit të dytë" zëvendësohen me fjalët "banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë".

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. "Baste sportive *online*" janë bastet e vendosura në faqe interneti, aplikacione ose platformë elektronike të dedikuar, të autorizuar dhe të monitorueshëm të subjekteve të licencuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, për ngjarjet sportive ose/dhe lojërat sportive, të cilat do të ndodhin në të ardhmen dhe që nuk përfshijnë garat e pistave.".

2. Pas pikës 20 shtohet pika 20/1 me këtë përmbajtje:

"20/1. "Lojë fati promocionale – *jackpot*" është loja që organizohet nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, kazino, resort kazino, kazino të vendosura në hotele me pesë yje, që promovon besnikërinë e klientit vetëm brenda ambienteve të autorizuara ku kryejnë veprimtarinë, sipas parashikimeve të licencës së tyre, sipas autorizimit përkatës të dhënë nga Komisioni i Licencave.".

3. Në pikën 21 pas fjalës "zara" shtohen fjalët "apo turnetë e lojërave, sipas një liste të autorizuar nga Komisioni i Licencave.".

4. Në pikën 28 fjala "bileta" zëvendësohet me fjalët "regjistrime elektronike që përmbajnë detajet e lojës së kryer nga klienti".

5. Pikat 30, 31 dhe 33 ndryshohen si më poshtë:

"30. "Person i lidhur" është personi i lidhur në marrëdhënie të ngushtë personale, pune apo biznesi me aplikantin, ku përfshihen bashkëshortët, bashkëjetuesit, prindërit, fëmijët, anëtarët e familjes sipas përbërjes së certifikatës familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, çdo person fizik ose juridik që ka marrëdhënie të ngushta ortakërie apo biznesi apo janë bashkëpronarë përfitues në persona juridikë ose fizikë, si dhe për sa parashikohet tjetër në legjislacionin në fuqi për parandalimin dhe konfliktin e interesave.

31. "Programe elektronike për lojëra basti" janë programet *software* të ideuara dhe të ndërtuara për të ofruar lojën e basteve sportive *online.*

33. "Pronar përfitues" ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për Regjistrin e Pronarëve Përfitues.".

6. Pas pikës 44 shtohen pikat 45 dhe 46 me këtë përmbajtje:

"45. "Media elektronike" është ofruesi i shërbimit mediatik, i cili përfshin, por nuk kufizohet në programe/publikime, përmbajtja e të cilave nëpërmjet internetit transmetohet/publikohet në mënyrë ditore ose periodike, me qëllim informimin, argëtimin dhe edukimin e publikut.

46. "Agjentët financiarë" janë ofruesit e shërbimeve të pagesave me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, të parashikuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave.".

Neni 3

Në nenin 6 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të pikës 1 pas fjalëve "21 vjeç" shtohet fjalia: "Përjashtimisht për kategoritë e lojërave të fatit Lotari Kombëtare dhe Bingo

Televizive, mosha e punësimit apo e lejimit për të luajtur në mjediset ku organizohen këto lojëra nuk mund të jetë nën 18 vjeç.".

2. Në fund të pikës 4, pas fjalëve "të fatit" shtohen fjalët "apo në faqe interneti, aplikacione ose platforma *online* për një periudhë 3 muaj, 6 muaj, 1 vit apo të përhershme".

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 më këtë përmbajtje:

"4/1. Organizatori i basteve sportive *online* është i detyruar të aktivizojë shërbimin e vetëpërjashtimit të lojtarit për një kohë zgjatje jo më shumë se 24 orë në faqet zyrtare të internetit dhe aplikacionet ku luhen bastet sportive *online.".*

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Kërkesa duhet të depozitohet pranë AMLF-së. Kërkesa mund të tërhiqet nga personat që e kanë paraqitur kërkesën, por jo më parë se 3 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës pranë AMLF-së. AMLF-ja duhet të mbajë një regjistër elektronik të personave për të cilët është vendosur moslejimi për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit. Ky regjistër elektronik krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. Regjistri do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë organizatorët e lojës së kategorisë përkatëse.

Rregulla të detajuara për paraqitjen, shqyrtimin, miratimin, anulimin apo refuzimin e kërkesës për moslejimin e personit për të hyrë në ambientet e lojërave të fatit, si dhe rregullat e mbajtjes e të funksionimit të regjistrit të personave për të cilët është vendosur moslejimi për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 4

Në nenin 7 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Organizatorët e lojërave të fatit janë të detyruar të vendosin në mënyrë dalluese në ambientet ku luhen lojëra fati, si dhe në *website*-et e tyre zyrtare, sipas formatit dhe përmbajtjes së miratuar nga Komisioni i Licencave, informacion në lidhje me masat mbrojtëse për lojtarët, mesazhe në lidhje me luajtjen e lojërave të fatit nga lojtarët në mënyrë të përgjegjshme, rreziqet e mundshme të lojërave të fatit, shanset reale për të fituar, si dhe informacionin e nevojshëm për strukturat që ofrojnë ndihmë në lidhje me trajtimin apo këshillimin për lojtarët apo familjarët e tyre për varësinë dhe problemet që shkaktojnë lojërat e fatit.".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Komisioni i Licencave harton dhe propozon programe të dedikuara për mbrojtjen e lojtarit, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale.".

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Ndalohet publiciteti i lojërave të fatit në medien e shkruar dhe atë audiovizive, me përjashtim të kushteve dhe mënyrës së parashikuar në këtë nen për publicitetin e lejuar.".

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3, 2/4, 2/5, 2/6, 2/7 e 2/8 me këtë përmbajtje:

"2/1. Publiciteti lejohet të kryhet nga organizatorët e lojërave të fatit të licencuara në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, si dhe në rregulloren e miratuar nga Komisioni i Licencave:

a) në medien elektronike;

b) në faqet *online* të autorizuara të këtyre subjekteve;

c) nëpërmjet vendosjes së materialeve vizuale në vende publike shprehimisht të përcaktuara në këtë ligj, si dhe vetëm në kushtet e parashikuara në këtë ligj.

2/2. Publiciteti lejohet të kryhet edhe në medien audiovizive nga organizatorët e lojërave të fatit "baste sportive *online",* "bingo televizive" dhe "lotari kombëtare" në kushtet si më poshtë:

a) nga organizatorët e lojërave të fatit "baste sportive *online"* gjatë kohës së transmetimit të eventeve sportive, si dhe gjatë kohës së transmetimit të programeve sportive të lidhura me këto evente sportive që transmetohen në intervalin kohor 22:00–08:00, si dhe vetëm në kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloren e miratuar nga Komisioni i Licencave;

b) nga organizatorët e lojërave të fatit "Lotari Kombëtare" dhe "Bingo televizive" për transmetimet në intervalin kohor ditor 18:00–08:00.

2/3. Publiciteti lejohet të kryhet nga organizatorët e lojërave të fatit të kategorisë "kazino", "kazino të vendosura në hotele me pesë yje" dhe "resort kazino" edhe në ambientet e porteve dhe aeroporteve, sipas kushteve të parashikuara në rregulloren përkatëse, të miratuar nga Komisioni i Licencave.

2/4. Në rastet e lejuara për publicitetin e aktivitetit të lojërave të fatit, organizatorët e lojërave të fatit kanë të drejtë ta kryejnë atë vetë ose nëpërmjet kontraktorëve, duke respektuar kushtëzimet e mëposhtme:

a) publiciteti nuk duhet të cenojë dinjitetin njerëzor;

b) publiciteti nuk duhet të jetë abuzues dhe i fshehtë;

c) publiciteti nuk duhet të inkurajojë konsumatorët për të investuar fitime në lojë fati;

ç) publiciteti nuk duhet të ketë përmbajtje të pavërtetë apo çorientuese, veçanërisht lidhur me mundësinë apo shumën e fitimeve dhe kushtet e pjesëmarrjes në lojë;

d) publiciteti nuk duhet të japë përshtypjen se pjesëmarrja në lojë është zgjidhje e problemeve financiare apo se pjesëmarrja në lojë sjell sukses social e financiar dhe kontribuon në përmirësimin e reputacionit të individit;

dh) publiciteti nuk duhet t'u adresohet të miturve;

e) publiciteti duhet të përmbajë dukshëm frazën "Lojërat e fatit krijojnë varësi. Kujdes në ushtrimin e tyre të tejzgjatur.";

ë) publiciteti në medien audiovizive është vetëm me fjalë të shkruara në kushtet e parashikuara në rregulloren përkatëse të miratuar nga Komisioni i Licencave, dhe në çdo rast duhet të shoqërohet nga logo e *website* ndihmuese, si dhe numrin e këshillimit nëse ka.

f) ndalohet publiciteti i aktivitetit të lojërave të fatit gjatë edicionit të lajmeve dhe programeve informative që lidhen me politikën.

2/5. Kushtëzimet e parashikuara në pikën 2/4 zbatohen edhe në rastin e publiciteteve brenda ambienteve të autorizuara të organizatorit të lojës "kazino", "kazino të vendosura në hotele me pesë yje" dhe "resort kazino", si dhe në publicitetin e lejuar për t'u kryer në ambientet e porteve dhe të aeroporteve.

2/6. Subjektet e licencuara për lojëra fati lejohen të sponsorizojnë skuadra sportive, si dhe të bëjnë publicitet të aktiviteteve të tyre në vendet ku zhvillohen veprimtari sportive, me përjashtim të eventeve sportive të të gjitha disiplinave për kategoritë nën 21 vjeç. Përjashtimisht organizatorët e licencuar në kategorinë "Baste sportive *online*" nuk lejohen të sponsorizojnë skuadra sportive.

2/7. Lejohet vendosja e materialeve vizuale, shenjave apo tabelave orientuese nga ana e organizatorit të lojërave të fatit të kategorisë "kazino", "kazino të vendosura në hotele me pesë yje" dhe "resort kazino" vetëm në hyrjen qendrore në kazino. Në çdo rast, tabela mund të përmbajë vetëm emrin apo *brand*-in e kazinosë dhe shigjetën drejtuese të orientuar drejt hyrjes së kazinosë.

2/8. Komisioni i Licencave miraton formatin dhe rregullat e transmetimit të publicitetit të lejuar të lojërave të fatit pas marrjes se mendimit të AMA-s.".

3. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 13 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në shkronjën "a" të pikës 1 pas fjalës "licencon" shtohen fjalët "nëpërmjet Komisionit të Licencave".

Neni 6/1

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 16/1

**Ndalimi për nëpunësit e AMLF-së dhe Komisionit të Licencave**

Nëpunësve të AMLF-së dhe anëtarëve të Komisionit të Licencave u ndalohet të luajnë lojëra fati në të gjitha kategoritë e lojës që janë përcaktuar në këtë ligj.".

Neni 7

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1, "Komisioni i Licencave", me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1
**Komisioni i Licencave**

1. Pranë AMLF-së ngrihet Komisioni i Licencave për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të paraqitura në lidhje me aktivitetin e lojërave të fatit, me këtë përbërje:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;

ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për drejtësinë;

d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;

dh) një përfaqësues nga Agjencia e Inteligjencës Financiare;

e) një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

2. Kryetari i Komisionit zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit me votim të fshehtë me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Emrat nominalë të anëtarëve të Komisionit të Licencave caktohen me urdhër të titullarit përkatës.

3. Ministrat, sipas parashikimit të pikës 1, mund të caktojnë si anëtarë edhe persona që nuk ushtrojnë funksione publike dhe që kanë jo më pak se 5 vjet përvojë pune. Anëtarët e Komisionit caktohen një herë në katër vjet.

4.Anëtarët e Komisionit kanë detyrim të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit dhe deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit, rast pas rasti, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit.

5. Komisioni i Licencave ka këto detyra:

a) përcakton mënyrën, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e thirrjes për licencimin e subjekteve të cilat organizojnë lojërat e fatit;

b) vlerëson për subjektet aplikuese përpara shpalljes së fituesit apo për organizatorët nëse ndryshojnë sistemin përputhshmërinë e sistemeve që do të përdoren për kryerjen e aktivitetit të lojërave të fatit “baste sportive *online”,* sipas përcaktimeve të këtij ligji;

c) administron listat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga AMLF-ja të subjekteve që kanë aplikuar për t’u pajisur me licencë për kryerjen e aktivitetit të lojës së fatit;

ç) vlerëson plotësimin e kushteve në lidhje me pajisjet për marrjen e licencës;

d) shqyrton dhe vlerëson aplikimet për marrje licence;

dh) harton programet e mbrojtjes së të drejtave të lojtarit, që miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

e) mbikëqyr zbatimin e programeve të mbrojtjes së të drejtave të lojtarit;

ë) kryen funksionin e sekretariatit të Këshillit të Mbështetjes së Projekteve;

f) miraton rregulloren e lojës së fatit që propozohet nga organizatori;

g) miraton standardet e specifikimeve teknike për pajisjet e lojërave të fatit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

gj)miraton rregulloren në lidhje me standardet, formën dhe mënyrën e publikimit/transmetimit të publicitetit të lejuar të lojërave të fatit nga ana e organizatorëve të lojërave të fatit në medien *online* apo ato audiovizive;

h) autorizon subjektet për të zhvilluar lojë fati promocionale – *jackpot;*

i) miraton listën e turneve të lojërave në kazino;

j) miraton rekomandimet periodike të nxjerra nga plani i veprimtarisë së inspektimeve të AMLF-së;

k) miraton kryerjen e auditimeve të sistemeve dhe/ose të performancës së veprimtarisë së organizatorëve të lojërave të fatit, të entiteteve të autorizuara nga AMFL-ja, sipas detyrave të objektit të auditimit të përcaktuara nga Komisioni, nga auditues ligjor dhe/ose teknik, të pavarur, vendas apo të huaj, të emëruar në aktin e auditimit;

l) harton raportin vjetor të veprimtarisë së tij, pjesë integrale e të cilit është edhe raporti i monitorimit për përdorimin e fondit të posaçëm në përputhje me qëllimin dhe termat e projektit;

ll) kryen funksione të tjera të parashikuara nga ky ligj apo ligje të tjera.

6. Funksionet e asistencës dhe të mbështetjes logjistike të Komisionit të Licencave realizohen nga AMLF-ja përmes punonjësve të caktuar që shërbejnë si sekretariat teknik për mbledhjet e Komisionit.

7. Organizimi i punës dhe i veprimtarisë së Komisionit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

8. Shpërblimi i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Licencave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk mund të jetë më pak se 25 000 lekë për mbledhje. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Licencave, si dhe çdo shpenzim tjetër për realizimin e detyrave të Komisionit të Licencave përballohet nga buxheti i AMLF-së.".

Neni 8

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b" e pikës 5 shfuqizohet.

2. Në pikën 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në fjalinë e parë togfjalëshi "10 ditë" zëvendësohet me togfjalëshin "5 ditë";

b) në fund të fjalisë së tretë togfjalëshi "5 m$^2$ zëvendësohet me togfjalëshin "2,5 m$^2$".

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. Organizatori duhet të njoftojë AMLF-në 7 ditë përpara për ndryshimin e personelit dhe 5 ditë përpara për mbylljen e çdo salle, ndryshimin e selisë, apo të numrit të mjeteve të lojërave për çdo sallë, në përputhje me licencën që zotëron."

4. Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën "a" togfjalëshi "jo më pak se 80 për qind" zëvendësohet me togfjalëshin "jo më pak se 50 për qind".

b) në shkronjën "c" togfjalëshi "jo më pak se 60 për qind" zëvendësohet me togfjalëshin "jo më pak se 50 për qind".

Neni 9

Në pikën 3 të nenit 19 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

a) "Baste sportive *online* dhe baste për garat në pistë" për të gjithë periudhën e licencimit është ajo për të cilën janë shpallur fitues në konkurrim, por jo më pak se 400 000 000 (katërqind milionë) lekë.".

2. Shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

dh) "Lotaria Kombëtare" për të gjithë periudhën e licencimit është ajo për të cilën janë shpallur fitues në konkurrim, por jo me pak se 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë.".

Neni 10

Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Bastet sportive *online* luhen nëpërmjet pajisjeve elektronike apo kompjuterike, si: *smartphone*, tabletëve, ipadëve, laptopëve, por pa u kufizuar vetëm në to, në faqet zyrtare të internetit, aplikacionet e subjekteve të licencuara për ushtrimin e aktivitetit "baste sportive *online*" dhe vetëm nëpërmjet programeve apo platformave të autorizuara nga Komisioni i Licencave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore.".

2. Pika 4 shfuqizohet.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Programet/sistemi/*website*-t/aplikacionet ku do të luhen bastet sportive *online* duhet të plotësojnë kushtet dhe standardet minimale të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.".

Neni 11

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 22

**Kriteret për licencimin e basteve sportive *online***

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, që kërkon të pajiset me licencë në kategorinë "Baste sportive *online*", duhet të përmbushë kriteret minimale, si më poshtë:

a) të jetë shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në objektin e veprimtarisë të së cilës të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati në kategorinë "Baste sportive *online*".

b) shuma e kapitalit të jetë jo më pak se 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, vlerë e cila nuk mund të jetë më e ulët për të tërë periudhën e vlefshmërisë së licencës.

c) të deklarojë burimin e kapitalit që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë për kategorinë "Baste sportive *online*".

ç) subjekti aplikues ose të paktën njëri prej aksionarëve të tij të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit në jo më pak se 3 shtete të BE/OECD dhe për jo më pak se 3 vjet. Nëse përvojën në fushën e lojërave të fatit e ofron njëri prej aksionarëve të subjektit aplikues, ai duhet të zotërojë jo më pak se 30 për qind të aksioneve në shoqëri.

d) subjekti aplikues ose të paktën njëri nga aksionarët duhet të ketë gjeneruar në vitin e fundit financiar të paktën 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë xhiro nga aktiviteti në fushën e lojërave të fatit, si dhe të ketë kapacitetet e duhura administruese, organizative dhe besueshmërinë e duhur për t'u angazhuar me sukses në aktivitete të tilla

dh) të paraqesë kufizimet për ndryshimet e pronësisë së aksioneve për të licencuarit në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

e) të disponojë marrëveshjen me subjektin për përdorimin e programeve/sistemeve/*website*-eve/aplikacioneve të nevojshme për të kryer aktivitetin e basteve sportive *online*. Nëse subjekti përdor sistemin/aplikacionin në pronësi të tij, duhet të jetë i miratuar edhe për këtë funksion.

ë) të paraqesë ofertën ekonomike të shumës që do të paguajë mbi tarifën e licencimit.

2. Për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, aplikuesi duhet të paraqesë këtë dokumentacion:

a) kopje të certifikatës së regjistrimit si sh.a., me numrin unik të identifikimit të subjektit aplikues.

b) ekstrakt historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku të vërtetohet se shoqëria është në status aktiv.

c) aplikuesi ose të paktën njëri prej aksionarëve të aplikuesit, që ka përvojë në fushën e lojërave të fatit, paraqet një listë të veprimtarive në fushën e lojërave të fatit, në kategorinë "Baste sportive", të shoqëruar me autorizimet, miratimet, licencat apo lejet, në bazë të të cilave i ushtron këto veprimtari.

ç) aplikuesi dhe aksionarët duhet të paraqesin dokumentacion për të vërtetuar origjinën e kapitaleve të tyre, të cilat do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë.

d) vërtetim nga një bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të garantuar se subjekti ka kapacitetet e duhura financiare për të përmbushur detyrimet e garancisë pasurore, në favor të ministrisë përgjegjëse për financat dhe AMLF-së, në përputhje me nenet 19, pika 3, shkronja "a", dhe 47, pikat 1 e 2, të këtij ligji.

dh) aksionarët e shoqërisë, kur këta të fundit janë persona juridikë, duhet të paraqesin aktet e themelimit dhe statutet e tyre, së bashku me certifikatën, nga organi që mban regjistrin tregtar në vend, ku të jenë evidentuar emrat e aksionarëve të tyre, pronarët përfitues dhe përqindja që ata zotërojnë në shoqëri; emrat e aksionarëve që zotërojnë të drejta të veçanta; emrat e anëtarëve të organeve drejtuese, si dhe të dhëna të tjera për organet drejtuese të tyre, në rast se kërkohet nga Autoriteti.

e) një biznesplan në të cilin të paraqitet mënyra si do të zhvillohet aktiviteti për të cilin kërkohet licenca për një periudhë minimumi 3-vjeçare. Në biznesplan të parashikohet, ndër të tjera, edhe mënyra e marrëdhënies së organizatorit të basteve sportive *online* me klientët.

3. Nëse aksionarët e subjektit aplikues janë individë, ata duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:

a) vërtetimin se individi nuk është i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë dhe nuk është në ndjekje penale apo në proces gjyqësor për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/ose doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale, që komprometojnë personin në nderin e personalitetin e tij.

b) vërtetimin nga Zyra e Përmbarimit Gjyqësor se individi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

c) aplikuesi duhet të paraqesë të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të aksionarëve të aplikantit për tre vjetët e fundit.

ç) aplikuesi duhet të dorëzojë, gjithashtu, edhe vërtetimet e lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial për subjektin, si më poshtë:

i. se nuk është në ndjekje penale;

ii. se nuk është në gjykim për vepra penale;

iii.se nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera nga Zyra e Përmbarimit Gjyqësor;

iv. se subjekti nuk është në procedurë falimentimi.

4. Përveç sa më lart, duhet të dorëzohet edhe dokumentacioni si më poshtë:

a) dëshmi penaliteti, e dorëzuar nga aplikanti/administratorët, aksionarët e shoqërisë dhe pronarët përfitues në momentin e aplikimit; vërtetime që nuk janë në proces gjyqësor apo që nuk janë dënuar penalisht me një vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie,

vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale, që komprometojnë personat në nderin e personalitetin e tyre. Në rastet kur aplikuesi, administratori apo aksionari janë persona fizikë/juridikë të huaj dhe këto dokumente/vërtetime nuk lëshohen nga institucionet përkatëse të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim.

b) një marrëveshje paraprake, të paktën me njërin nga agjentët financiarë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave të klientëve, në përputhje me veprimtaritë financiare për të cilat janë licencuar, si dhe me biznesplanin e paraqitur.

c) çdo informacion tjetër, të cilin autoriteti i autorizuar e gjykon të nevojshëm t'ia kërkojë aplikantit për fushën e veprimtarisë në kategorinë "Baste sportive *online*".

ç) përveç dokumentacionit të sipërpërmendur, aplikuesi duhet të paraqesë një vetëdeklarim se nuk është në ndjekje penale, si dhe një dokument që vërteton se subjekti aplikues ka shlyer:

- detyrimet fiskale, lëshuar nga administrata tatimore;
- të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore.

d) deklaratën e subjektit aplikues, me anë të së cilës subjekti merr përsipër dhe garanton vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura në dosje;

dh) deklaratën që subjekti aplikues nuk rezulton debitor ndaj institucioneve shtetërore dhe ka shlyer detyrimet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;

e) deklaratën se subjekti aplikues nuk ka në përbërjen e tij ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit që rezultojnë debitorë ndaj institucioneve shtetërore;

ë) deklaratën që subjekti aplikues nuk ka ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë, anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit, që rezultojnë të dënuar penalisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprat penale të parashikuara në ligj;

f) projektrregulloren e lojës, të hartuar sipas kërkesave të nenit 23 të ligjit.

Përveç certifikatës së regjistrimit, që vërteton regjistrimin e subjektit, dokumentet që vërtetojnë kriteret sipas legjislacionit të lojërave të fatit duhet të jenë lëshuar/miratuar nga organet përkatëse, brenda 3 muajve të fundit nga data e aplikimit.

5. Subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumente për kapacitetet organizative dhe administrative si më poshtë:

a) deklaratën për fuqinë mesatare punëtore dhe për numrin e stafit drejtues;

b) informacion për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion aplikuesit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga licenca, si dhe marrëveshjen me persona të tretë për ofrimin e programeve/sistemeve/*website*-eve/aplikacioneve të nevojshme për të kryer aktivitetin e basteve sportive *online;*

c) informacion dhe të dhëna teknike për pajisjet elektronike që përdoren apo do të përdoren nga aplikanti, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, me qëllim dhënien e aksesit AMLF-së në kohë reale në sistemin *back office*, për çdo transaksion që do të kryhet ndërmjet subjektit dhe lojtarëve, xhiron e fitimin, si dhe çdo të dhënë që do të kërkohet nga autoriteti.

6. Subjekti aplikues ose të paktën njëri prej aksionarëve të aplikuesit duhet të provojë se ka eksperiencë në fushën e lojërave të fatit, duke paraqitur një informacion të detajuar për këtë eksperiencë, të shoqëruar edhe me një listë të licencave, të shoqëruar për çdo licencë me dokumentacion provues, kualifikimeve dhe stafit kryesor të tij, si dhe çdo dokument tjetër mbështetës që vlerësohet si i nevojshëm.

7. Subjekti aplikues duhet të dorëzojë listën e deklaratave në lidhje me:

- *software*-in që përdor apo propozohet të përdoret;
- modele të licencave dhe certifikatave SSL që përdor apo propozohen të përdoren;
- çdo standard apo certifikim të njohur ndërkombëtarisht ISO 9001, 27001 etj.

8. Subjekti aplikues duhet të paraqesë informacionin e detajuar lidhur me sistemin ku do të zhvillohen lojërat "bastet sportive *online*", ku të përfshihen:

a) platforma skematike e komunikimit server-klient, server-AMLF;

b) siguria që do të instalohet për këtë sistem;

c) të dhënat e plota teknike për serverat, pajisjet në platformat-klient dhe të gjitha pajisjet e tjera që shërbejnë për *rout*-in, pajisjet për ruajtjen e informacionit (*back up*), DRC (*Disaster Recovery*), BCC (*Business Continuity Center*) dhe sigurinë e instaluar në këtë platformë.

Sistemi duhet të operojë mbi një server të monitorueshëm *online* nga AMLF-ja.

9. Autoriteti ka të drejtë të verifikojë çdo informacion dhe dokument të depozituar nga aplikuesi. Për këtë, aplikuesi përfshin në aplikimin e tij një autorizim, që autorizon autoritetin për të bërë, pa asnjë kufizim, verifikimin e dokumentacionit dhe/ose të informacionit të dhënë në aplikim. Mosdhënia e autorizimit sipas kësaj pike sjell refuzimin e aplikimit.

10. Subjekti aplikues paguan një tarifë për aplikimin për licencë në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, e cila kalon në favor të AMLF-së dhe është e pakthyeshme, pavarësisht aplikimit të suksesshëm apo jo të subjektit.".

Neni 12

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Në titull pas fjalës "fatit" shtohen fjalët "baste sportive *online"*.

2. Fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Rregullorja e lojës së fatit "Baste sportive *online"* propozohet nga organizatori dhe miratohet nga Komisioni i Licencave.".

3. Në shkronjën "a" fjalët "oraret e funksionimit të sallave të basteve" shfuqizohen.

4. Në shkronjën "e", pas fjalës "biletës" shtohet fjala *"online"*.

Neni 13

Pikat 1 dhe 2 të nenit 24 riformulohen si më poshtë:

"1. Organizatori pranon pagesat dhe autorizon tërheqjet për bastet sportive *online* vetëm nëpërmjet agjentëve financiarë. Procedurat dhe standardet në lidhje me kryerjen e pagesave dhe mënyrën e pranimit apo tërheqjes së tyre kryhen në përputhje me marrëveshjen specifike të organizatorit të lojës së fatit me agjentin financiar përkatës, në përputhje me veprimtaritë financiare për të cilat agjenti financiar është licencuar nga Banka e Shqipërisë, sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat.

2. Me vendim të Këshillit të Ministrave pas marrjes së mendimit të Agjencisë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike përcaktohen standardet që kanë të bëjnë me kushtet teknike të sistemit të basteve sportive *online,* duke përfshirë, por pa u kufizuar në identifikimin dhe regjistrimin e lojtarëve, kërkesat e programeve *software* dhe *hardware*, certifikimin e sistemit, procedurat në lidhje me faturat dhe transaksionet e pagesave, parimet e sigurisë dhe kushtet e kontrollit apo mbikëqyrjes.".

Neni 14

Në pikën 3 të nenit 26 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët "pajisje bastesh" zëvendësohet me fjalën "sisteme".

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronjat "d" dhe "dh" ndryshohen si më poshtë:

"d) ka detyrimin të regjistrojë paraprakisht çdo lojtar që do të marrë pjesë në baste sportive *online,* si dhe të marrë e të ruajë të dhëna për identitetin e tyre për të paktën 3 vjet. Ruajtja e këtyre të dhënave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

dh) organizatori i basteve sportive *online* nuk duhet të pranojë para në dorë nga lojtarët, por vetëm nëpërmjet agjentëve financiarë të autorizuar sipas këtij ligji.".

b) Në shkronjën "f", pas fjalëve "bankat e nivelit të dytë" shtohen fjalët "apo institucione financiare".

Neni 15

Pas nenit 27 shtohen nenet 27/1, 27/2, 27/3 dhe 27/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1
**Procedura për dhënien e licencës baste sportive *online***

1. AMLF-ja publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, në 2 gazeta ndërkombëtare, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin për konkurrim për dhënien e licencës për ofrimin e basteve *online,* të cilat janë të kufizuara në numër në rang kombëtar jo më shumë se 10 (dhjetë).

2. Njoftimi përmban:

a) listën e dokumentacionit;

b) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;

c) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

d) vendin, datën dhe orën e shqyrtimit të dokumenteve.

3. Thirrja për konkurrim, numri i licencave që do të jepen në një thirrje dhe elementet e përmbajtjes së njoftimit përcaktohen me vendim të Komisionit të Licencave.

Neni 27/2
**Procedura e përzgjedhjes së subjektit fitues**

1. Përzgjedhja e subjektit kryhet nga Komisioni i Licencave, në përputhje me kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Anëtarët e Komisionit të Licencave vetëdeklarojnë, nën përgjegjësinë tyre, se pjesëmarrja në këtë komision nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim. Për mosdeklarim, zbatohen masat e parashikuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

3. Komisioni i Licencave brenda 10 ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes miraton listën e pjesëmarrësve në konkurrim, duke renditur, sipas pikëve të marra, aplikantët të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret, sipas këtij ligji. Kandidati, i cili ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.

4. Lista e pjesëmarrësve në konkurrim, sipas renditjes së parashikuar në pikën 3, dhe njoftimi i fituesit publikohen në faqen zyrtare të AMFL-së.

5. Brenda 10 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit subjektet pjesëmarrëse në konkurrim kanë të drejtë t'i paraqesin ankim ministrit përgjegjës për financat për procedurën e zhvilluar.

6. Ministri përgjegjës për financat nëpërmjet një komisioni *ad hoc* të shqyrtimit të ankesave, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon shqyrtimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë.

7. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimit të tyre Komisioni i Licencave miraton dhënien e licencës, pasi aplikanti i shpallur fitues të ketë paraqitur brenda 30 ditëve plotësimin e kriterit të lidhur me fondin e garancisë.

Neni 27/3
**Pezullimi dhe revokimi i licencës**

1. Organizatori ka detyrimin që të përmbushë kriteret në bazë të të cilave është licencuar gjatë gjithë afatit të ushtrimit të veprimtarisë. Mospërmbushja e kritereve bazë të licencimit pas marrjes së licencës është shkak për pezullimin/revokimin e saj.

2. Çdo masë që merret lidhur me vijimësinë e procesit pas shqyrtimit dhe propozimit nga Komisioni i Licencave, ministri përgjegjës për financat e shoqëron me një urdhër të arsyetuar për pezullimin e licencës apo revokimin e saj. Procedura dhe afatet për pezullimin apo revokimin e licencës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27/4
**Ndryshimi i të dhënave**

Mbajtësi i licencës është i detyruar të njoftojë AMFL-në brenda dhjetë ditëve pune për të gjitha ndryshimet dhe devijimet nga masat e planifikuara më herët në planin e zhvillimit të aktivitetit. Subjekti i licencuar i drejtohet AMFL-së me një informacion me shkrim, duke përshkruar çdo fakt e rrethanë që ka sjellë ndryshime apo devijime nga planifikimi. AMFL-ja mbikëqyr veprimtarinë e subjektit të licencuar dhe informon ministrin përgjegjës për financat duke zbatuar parashikimet e këtij ligji.".

Neni 16

Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Licenca për të drejtën e organizimit të lojërave të Lotarisë Kombëtare është një e vetme dhe i jepet për një periudhë 10-vjeçare subjektit aplikues, i cili përzgjidhet i pari në procesin e konkurrimit, të zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Licenca miratohet me vendim të Komisionit të Licencave dhe bëhet efektive pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet të licencuarit, Drejtorit të Përgjithshëm të AMLF-së dhe kryetarit të Komisionit të Licencave.”.

2. Në fund të shkronjës “c” të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Nuk pajisen me NIUS sekondar adresat e bizneseve të tjera që kanë NIUS për veprimtarinë që ushtrojnë, nëse në to, bazuar në kontratën që kanë me operatorin, shiten biletat e Lotarisë Kombëtare.

Neni 17

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. AMLF-ja shpall hapjen e garës për dhënien e licencës për Lotarinë Kombëtare, me propozim të Komisionit të Licencave”.

2. Këshilli i Ministrave miraton kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit për dhënien e licencës për “Lotarinë Kombëtare.”.

2. Në pikën 3 fjalët “autoriteti i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për organizimin e garës” zëvendësohen me fjalët “AMLF-ja”.

Neni 18

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “autoriteti i autorizuar nga ligji” zëvendësohen me fjalët “AMLF-ja”.

2. Në shkronjën “c” të pikës 2 togfjalëshi “1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë)” zëvendësohet me togfjalëshin “40 000 000 (dyzet milionë)”.

3. Shkronja “dh” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“dh) dokumentin, ku të shënohet se subjekti aplikues ose të paktën njëri prej aksionarëve të tij të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit në jo më pak se 3 shtete të BE/OECD-së dhe për jo më pak se 3 vjet.”.

4. Pas shkronjës “gj” të pikës 2 shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) ofertën ekonomike të shumës që do të paguajë mbi tarifën e licencimit.”.

5. Në shkronjën “e” të pikës 3 pas fjalëve “bankat e nivelit të dytë ” shtohen fjalët “apo institucione financiare”.

6. Në shkronjën “ë” të pikës 3 dhe në pikën 4 emërtimi “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave” zëvendësohet me “Komisioni i Licencave”.

Neni 19

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përzgjedhja e subjektit për lojërat e fatit “Lotari Kombëtare” bëhet nga Komisioni i Licencimit në përputhje me kriteret e vlerësimit, afatet, procedurën e konkurrimit dhe metodologjinë e pikëzimit të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij.”.

2. Fjalia e parë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Anëtarët e Komisionit të Licencimit duhet të vetëdeklarojnë nën përgjegjësinë e tyre se pjesëmarrja në këtë procedurë përzgjedhëse konkurrimi nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim.”.

3. Në pikën 3 emërtimi “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave” zëvendësohet me emërtimin “Komisioni i Licencave”.

4. Në pikën 4 fjalët “autoriteti i autorizuar nga ligji” zëvendësohen me fjalët “AMLF-ja”.

Neni 20

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Pas miratimit të listës së pjesëmarrësve në konkurrim, AMLF-ja bën publikimin e njoftimit të fituesit në faqen zyrtare të internetit të AMLF-së. Brenda 30 ditëve nga data e publikimit të njoftimit, aplikanti ka të drejtë t’i paraqesë ankim ministrit

përgjegjës për financat në lidhje me procedurën e zhvilluar.

**2.3 Kostot operative dhe administrative**

GIZ-i do të mbulojë kostot operative dhe/ose administrative që lidhen me përpunimin e kontributit gjerman në program.

**2.4 Kontribute të tjera**

GIZ-i do të ofrojë subvencione vendore dhe/ose prokurim të pajisjeve të vogla deri në 1.322.862 euro dhe marrëveshje financimi deri në 620.440 euro (financuar nga BMZ-ja: për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve të qyteteve pilot: Himarë, Peqin, Cërrik 150.000 euro dhe 418.530 00 euro për pajisje për SHA UK, AKUM dhe masa të lidhura me COVID-19) dhe deri në 274.500 euro për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve Shkodër/Velipojë, Lezhë, Durrës, Kavajë, Vlorë/Orikum, Sarandë në varësi të nevojave, financuar nga EUSWAM).

**3. Kontributet nga organizatat partnere MIE**

**3.1 Sigurimi** i **ekspertëve dhe personelit ndihmës**

Organizata partnere zbatuese duhet:

- Të sigurojë një menaxher të kualifikuar për të udhëhequr programin e përgjithshëm;

- Të sigurojë ekspertët e mëposhtëm për të punuar në program (numri, kualifikimet, periudha):

- Ekspertë për të marrë pjesë në projekt (zyrtarë nga MIE, AMBU-ja, ERRU-ja, SHUKALB-i, bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve) dhe për trajnime të mëtejshme (të specifikuara në seminarin e planifikimit);

- 1 ekspert planifikimi, monitorimi dhe vlerësimi, gjatë të gjithë kohëzgjatjes së projektit;

- krijimi dhe formalizimi i një grupi pune që funksionon gjatë projektit me një agjendë të qartë bashkëpunimi me përfaqësues nga MIE (AKUM-i, DPZHUKM-ja), ERRU-ja, SHUKALB-i dhe bashkitë pjesëmarrëse, dhe shoqëritë përkatëse. Grupi i punës do të ndihmohet nga GIZ-i, në lidhje me ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e performancës dhe llogaridhënies, dhe përgjegjës për zbatimin e menaxhimit të njohurive të projektit;

- lehtëson kontaktet me aktorët përkatës në sektorin e ujit dhe ministritë e tjera përkatëse, si: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**3.2 Kostot**

Organizata partnere do të mbulojë të gjithë TVSH-në për aktivitetet e programit që përfitojnë institucionet e tyre dhe shpenzimet e lidhura me to në Shqipëri (kostot e funksionimit dhe prokurimet), si dhe për prokurimet/importet ndërkombëtare. Sigurimi i buxhetimit të mjaftueshëm deri në mbylljen financiare të programit, deri më 31.5.2023. Angazhimi për të siguruar rimbursimin e TVSH-së është i vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të programit.

Shuma totale e TVSH-së, e parashikuar për rimbursim për të gjithë afatin e projektit, është rreth 540.000 euro.

**3.3 Sigurimi i vendit, ndërtesave dhe mjediseve të punës**

Organizata partnere do të vërë në dispozicion të programit zyrën pa pagesë (nëse disponohet) dhe aksesin në sallat e konferencave, duke përfshirë pajisjet për të kryer aktivitete dhe trajnime të lidhura me programin.

Organizata partnere udhëzon bashkitë që të vënë në dispozicion të programit një zyrë për këshilltarët dhe ekspertët afatshkurtër të GIZ-it, duke përfshirë pajisjet dhe orenditë, në masën që këto pajisje dhe orendi nuk ofrohen nga GIZ-i.

**4. Dispozita të tjera**

**4.1 Vlerësimi**

GIZ-i ndërmerr një vlerësim të programit gjatë ose pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim, GIZ-i nënkontrakton ekspertët/vlerësuesit e programit. Organizata partnere MIE merr pjesë në vlerësim. Në të gjitha rastet ndihmon ekspertët/vlerësuesit në punën e tyre dhe i lejon të shqyrtojnë të gjitha dokumentet e nevojshme.

MIE informon për rezultatet e vlerësimit me anë të raporteve.

**4.2 Pezullimi i kontributeve dhe zgjidhja e marrëveshjes**

GIZ-i pezullon kontributin e saj nëse:

- Organizata partnere nuk arrin të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje ose nga kontratat në lidhje me këtë marrëveshje; ose

- Rrethanat që vijnë, të cilat përjashtojnë apo rrezikojnë ndjeshëm objektivin e programit, të përshkruar në nenin 1 më sipër.

Nëse rrjedh një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më sipër dhe ekziston ende pas një afati të rënë dakord nga GIZ-i me organizatën partnere ose nëse nuk zgjidhet brenda kësaj periudhe, GIZ-

i, me miratimin e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të zgjidhë para kohe zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

**4.3 Afati i marrëveshjes**

Përveç se kur parashikohet në nenin 4 më sipër, për pezullimin e kontributeve dhe zgjidhjen e marrëveshjes, kjo marrëveshje është e vlefshme për kohëzgjatjen e fazës vijuese të programit (aktualisht e planifikuar të vazhdojë nga tetori 2016 deri në maj 2023). Ndërkohë, marrëveshja e zbatimit mbetet në fuqi për një periudhë shtesë prej shtatë muajsh, deri më 31.12.2023, për të mundësuar mbylljen financiare dhe dorëzimin e dokumentacionit të përshtatshëm te pala tjetër. Afati i kësaj marrëveshjeje mund të zgjatet në rast të vonesave në zbatim të kontributeve të palës gjermane, sipas kushteve të shkruara në marrëveshjen e zbatimit dhe kontributeve të rëna dakord me organizatën partnere. Zgjatja e afatit të kësaj marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjitha palët e përfshira.

**4.4 Rregullimi i marrëveshjes**

Nëse dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk ndihmojnë në arritjen efikase të objektivit të përcaktuar në nenin 1 më sipër, atëherë GIZ-i dhe organizata partnere mund të rregullojnë ose ndryshojnë këto dispozita, me pëlqim të ndërsjellë, në çdo fazë gjatë zbatimit të programit. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim.

GIZ-i mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë marrëveshje, nëse mandati me të cilin është ngarkuar nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë është tërhequr.

**4.5 Forma e shkruar**

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj marrëveshjeje, si edhe deklaratat dhe komunikimet e tjera të rëndësishme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje bëhen me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, është e mjaftueshme që ato të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion.

**4.6 Marrëveshjet me organizata zbatuese individuale**

Personi përgjegjës për kontributin nga GIZ-i dhe personat përgjegjës për kontributet nga organizata partnere ose organizata të tjera zbatuese mund të lidhin bashkërisht një marrëveshje detyruese, për detaje shtesë në lidhje me zbatimin e programit (p.sh. në bazë të një plani të veprimeve), ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme për të përcaktuar ato detaje me shkrim dhe, kur është e nevojshme, për të rregulluar ndonjë marrëveshje të tillë për të marrë parasysh zhvillimet e programit.

**4.7 Zbatimi i marrëveshjes**

Në lidhje me dispozitat që nuk mbulohen nga kjo marrëveshje, i referohet dispozitave të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe qeverisë së Shqipërisë për bashkëpunim teknik dhe marrëveshjen/shkëmbimin e notave ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe qeverisë së Shqipërisë, për angazhimet në lidhje me bashkëpunimin teknik, të dyja të përmendura në fillim të kësaj marrëveshjeje.

**4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve, rekomandohet që të zgjidhet me anë të bisedimeve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje e tillë, komunikimi duhet të ndiqet përmes kanaleve diplomatike.

**4.9 Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas përmbushjes së procedurave të brendshme të palëve. Ajo do të hartohet në dy origjinale: në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e tekstit, gjuha angleze do të ketë përparësi.

Tiranë

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

____________________

Znj. Belinda Balluku
ZËVENDËSKRYEMINISTRE DHE MINISTRE E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

GIZ-i

____________________

Dr. Sonja Kurz
DREJTORE VENDI E GIZ-it PËR SHQIPËRINË

**VENDIM**
**Nr. 116, datë 6.3.2024**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHTESË TË MARRËVESHJES SË GRANTIT DHE PROJEKTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (MARRËSI) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) DHE *KFW FRANKFURT AM MAIN (KFW),* PËR PROGRAMIN E RINDËRTIMIT TË NDËRTESAVE PUBLIKE (FAZA I), MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1150, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shtesë të marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (marrësi) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe *KfW Frankfurt am Main (KfW),* për programin e rindërtimit të ndërtesave publike (faza I), miratuar me vendimin nr. 1150, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, me një grant në shumën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE SHTESË GRANTI**
DATË 1.2.2024
NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E GRANTIT DHE PROJEKTIT, DATË 11 DHJETOR 2020 ("**MARRËVESHJA FILLESTARE E GRANTIT**") NDËRMJET **KFW, FRANKFURT AM MAIN ("KfW")** DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË ("**MARRËSI**") DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (ADF) ("**AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT**")
PËR 3,500,000.00 EURO
- PROGRAMI PËR RINDËRTIMIN E GODINAVE PUBLIKE (FAZA I) – BMZ – NR. 2019 69 542

**Përmbajtja**

Seksioni 1 – Termat
Seksioni 2 – Ndryshimet e marrëveshjes fillestare të Grantit
Seksioni 3 – Dispozitat shtesë
Seksioni 4 – Parashikimi i termave

Në lidhje me Marrëveshjen Fillestare të Grantit, Marrësi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen shtesë të mëposhtme të grantit ("Marrëveshja Shtesë e Grantit").

**Seksioni 1 – Termat**

Në bazë të ndonjë dispozite të shprehur për të kundërtën në këtë Marrëveshje Shtesë të Grantit ose nëse konteksti nuk e parashikon ndryshe, termat e përcaktuar në Marrëveshjen Fillestare të Grantit do të kenë kuptim të njëjte edhe në këtë Marrëveshje Shtesë të Grantit.

**Seksioni 2 – Ndryshimet e Marrëveshjes Fillestare të Grantit**

**2.1** Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes fillestare të Grantit do të ndryshohen si më poshtë:

a) Fjalia e parë e nenit 1.1 do të fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

"KfW-ja i jep Marrësit një shumë që nuk kalon totalin prej 14.500.000.00 eurosh (me fjalë: 14 milionë e pesëqind mijë euro) ("**Granti**)."

**2.2** Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes fillestare të Grantit mbeten të pandryshuara.

**Seksioni 3 – Dispozitat shtesë**

Me përjashtim të nenit 9.5 të Marrëveshjes fillestare të Grantit, marrëdhëniet juridike të

vendosura nga Marrëveshja fillestare e Grantit dhe kjo Marrëveshje Shtesë Granti ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë me realizimin e suksesshëm të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Shtesë të Grantit.

**Seksioni 4 – Përmbajtja e termave**

Dispozitat e nenit 5 (Kostot dhe tarifat publike), neneve 6.1 dhe 6.2 (Deklaratat kontraktuale dhe kompetencat e përfaqësimit) dhe neneve 9.2, 9.3 dhe 9.4 (Dispozita të ndryshme) të Marrëveshjes fillestare të Grantit do të përfshihen në këtë Marrëveshje Shtesë Granti dhe do të jenë pjesë integrale e Marrëveshjes Shtesë të Grantit. Në rastet kur në klauzola referohet për "Marrëveshjen" ose "këtë Marrëveshje", këto referenca janë për këtë Marrëveshje Shtesë Granti.

Hartuar në 3 dokumente origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, 1.2.2024
[Vendi dhe data]

**KfW**

______________________________
Emri: Arne Goss
Titulli: Drejtor i Departamentit
Infrastruktura Bashkiake
Evropa Juglindore dhe Turqia

______________________________
Emri: Brit Horschke
Titulli: Drejtor i vendit KfW

**Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë**

______________________________
Emri:
Titulli: Zëvendësministër

**Përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**
**Ami Kozeli**

**Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ADF)**

**Dritan Agolli**

______________________________
Emri:
Titulli: Drejtor Ekzekutiv

**VENDIM**
**Nr. 117, datë 6.3.2024**

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 822, DATË 7.10.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA PRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, të miratuara me vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3, në termin "Vetëprodhues", fjalët "... pjesën më të madhe të energjisë së prodhuar:" zëvendësohen me "... një pjesë të energjisë së prodhuar dhe i cili nuk përfiton nga skemat e mbështetjes sipas parashikimeve të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme";".

2. Në pikën 1, të nenit 6, pas togfjalëshit "... në nenet 7 ..." shtohet "... 7/1 ...".

3. Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 7/1
**Kërkesa për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike eolike**

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike eolike, subjekti i interesuar shpreh interesin për ndërtimin e një impianti eolik, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:

a) Dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien

afatgjatë mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues. Kërkesa refuzohet në rastet kur pasuria ku propozohet ndërtimi ka kufizime shfrytëzimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zonave të mbrojtura.

b) Një studim parafisibiliteti, i hartuar nga persona juridikë ose fizikë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale të studimit dhe/ose projektimit, të impianteve nga burimet e rinovueshme të energjisë, të projektit të propozuar, si dhe ndikimin e tij mjedisor e social, i cili duhet të shoqërohet me paraqitjen e përgjithshme skematike të burimit gjenerues të energjisë, një diagram elektrik të agregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes, shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre dhe koordinatat në sistemin koordinativ gjeohapsinor KRGJSH) dhe të paraqitura në hartë, me shkallë 1:25'000 dhe një hartë topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës që lidh burimin gjenerues me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes, në shkallë 1:25'000.

2. Nëse ministria konstaton se shprehja e interesit plotëson kriteret teknike, ligjore, marrëdhënien me pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues, i jep kërkuesit të drejtën prioritare për aplikimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe kryerjen e matjeve reale për një periudhë jo më pak së 12-mujore në zonën e propozuar për zhvillimin e projektit. Kur kërkesa pranohet, ministria publikon tri ditë me radhë, në faqen e *website*-it të ministrisë, një njoftim me të dhëna përshkruese për projektin e propozuar.

3. Subjektet pas marrjes së këtij miratimi brenda një afati 6-mujor duhet të raportojnë lidhur me instalimin e pajisjeve dhe fillimin e matjeve.

4. Në përfundim të këtij afati dhe bazuar në matjet reale të potencialit të erës në zonën e propozuar, kërkuesi paraqet dokumentacionin sipas parashikimeve të nenit 6, për vijimin e procedurave të mëtejshme për t'u pajisur me miratim paraprak për vazhdimin e procedurave për ndërtimin e kapacitetit të ri prodhues të energjisë elektrike eolike, sipas përcaktimit në këtë rregullore.

5. Subjektet kërkuese, të cilat zotërojnë të dhëna të mbledhura të erës, për zonën e tyre të interesit, mund të vijojnë drejtpërdrejtë aplikimin për miratim, sipas parashikimeve të këtyre rregullave.".

4. Në shkronjën "DH", të nenit 9, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Nënndarjet "- llojin e lëndës djegëse;", "-konsumin specifik të lëndës djegëse;"; dhe "-fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;" shfuqizohen;

b) Shtohet nënndarja, me këtë përmbajtje:

"- Deklarimin e pranimit të një pike lidhjeje në rrjet me një drejtim, e ndryshme nga pika e furnizimit dhe pranimit të përjashtimit nga skemat e mbështetjes për vetëprodhuesit.".

5. Pas paragrafit të parë, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 10, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Për aplikimet për burime gjeneruese eolike, të zotërojë të dhëna të matura të erës, të mbledhura nëpërmjet matjeve, për zonën e propozuar të zhvillimit të projektit.".

6. Në nenin 20 shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) oponencën teknike për projektpropozimin nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).".

7. Shkronja "dh", e nenit 22, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"dh) të drejtën për të monitoruar, mbikëqyrur, testuar dhe certifikuar impiantin dhe veprimtarinë e Mbajtësit të Miratimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nën mbikëqyrjen e ministrisë përgjegjëse për energjinë.".

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 118, datë 6.3.2024**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 823, DATË 19.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 400 kV SHQIPËRI–MAQEDONI E VERIUT'"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, si dhe të neneve 5 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 823, datë 19.12.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3, 4, 10 e 12 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", "vresht", "ullishte", "pemëtore" dhe "truall", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 5 808 101 (pesë milionë e tetëqind e tetë mijë e njëqind e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 808 101 (pesë milionë e tetëqind e tetë mijë e njëqind e një) lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

...

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

...

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë së pasurive që shpronësohen sipas këtij vendimi në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.".

b) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Kalimi i pronësisë së pasurisë në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), sipas vendimit nr. 823, datë 19.12.2022, "Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri-Maqedoni e Veriut'", shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 823, DATË 19.12.2022, 'PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 400 kV SHQIPËRI–MAQEDONI E VERIUT'''

| Nr. rendor | Nr. shtylle | PRONARI | | | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | Shënime Seksioni D-E i kartelës, adresa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Shpronësim "ndërtesë" | | | VLERA totale (lek) | |
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati ose qyteti | Zona kadastrale | Nr. pas. | Lloji pas. | Sip. totale(m²) | Sip. (m²) | Çmimi (lek/m²) | Vlera (lek) | | |
| 1 | 98-99 | Shpetim Selida | Nezir Agim | Kerçini Kerçini | Hotolisht | 2200 | 123/5 | Truall | 28 | 28 | 28600 | 800800 | 800,800 | Regjistruar me dokument nr. 210 objekt me leje legalizimi godinë banimi 1- katëshe, kati përdhes: S= 28 m². Shpronësohet vetëm godina e banimit me sipërfaqe 28 m², për shkak të distancës së sigurisë nga zhvendosja maksimale e përcjellësit, sipas VKM-së nr. 482, datë 17.6.2020. Adresa: Fshati Hotolisht, NJA Hotolisht, Bashkia Librazhd |
| VLERA TOTALE | | | | | | | | | | | | | **800,800** | |

## VENDIM
## Nr. 119, datë 6.3.2024

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION DHE NDËRTIM I RRUGËVE 'KSANTHIPI ZYKO' DHE 'ABDYL YPI', BASHKIA DURRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion dhe ndërtim i rrugëve 'Ksanthipi Zyko' dhe 'Abdyl Ypi', Bashkia Durrës".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Durrës.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 9 241 113.3 (nëntë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tre) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 9 241 113.3 (nëntë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tre) lekësh përballohet nga Bashkia Durrës.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Durrës.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Durrës.
8. Bashkia Durrës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Durrës.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Durrës, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Durrës, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION DHE NDËRTIM I RRUGËVE ‘KSANTHIPI ZYKO’ DHE ‘ABDYL YPI’, BASHKIA DURRËS”

| Nr. | PRONARI | | | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | | | Vlera totale/lekë | Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | TRUALL | | | NDËRTESË | | | | |
| | Emër | Atësia | Mbiemër | Fshati/qyteti | Z. kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. totale/$m^2$ | Truall/$m^2$ | Ndërtesë/$m^2$ | Sipërfaqja/$m^2$ | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera/lekë | Sipërfaqja/$m^2$ | Çmimi (lekë/$m^2$) | Vlera/lekë | | |
| 1 | Albert | Hasan | Abazaj | Durrës | 8513 | 2/927 | Truall | 509 | 509 | 260 | 220 | 12,945 | 2,847,900 | 0 | 0 | 0 | 2,847,900 | Konfirmuar nga ASHK-ja. |
| 2 | Hasan | | Abazi | Durrës | 8513 | 2/929/ND | Ndërtesë | 20 | 0 | 20 | 0 | 0 | 0 | 20.00 | 67,500 | 1,350,000 | 1,350,000 | Konfirmuar nga ASHK-ja, E- Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 2/645 vol. 38 fq. 245. D- e vlefshme vetëm për të mundësuar blerjen e trualli. Pasuria nr. 2/645, sipas kartelës së pasurisë është në pronësi shtet. |
| 3 | Nurije | | Falli | Durrës | 8513 | 2/643 | Truall | 134,94 | 134,94 | 59 | 76 | 12,945 | 983,043.3 | 59 | 67,500 | 3,982,500 | 4,965,543.3 | Konfirmuar nga ASHK-ja, vihet ne H/L në favor të Fondit Besa me k. hip nr. 1778/486/4 datë 26.6.2018. Sipas shkresës nr. 10/1 prot., datë 17.1.2024, të Bashkisë Durrës, lëvrimi i fondit të shpronësimit do të qëndrojë e ngrirë deri në sqarimin e barrës hipotekore me vendim Gjykate të formës së prerë. |
| 4 | Lavdrim | | Balla | Durrës | 8513 | 2/997 | Truall | 103 | 103 | 52 | 6 | 12,945 | 77,670 | 0 | 0 | 0 | 77,670 | Konfirmuar nga ASHK-ja. |
| | Drita | Musa | Balla | | | | | | | | | | | | | | | |
| | VLERA TOTALE | | | | | | | | | | | | 3,908,613.3 | | | 5,332,500 | 9,241,113.3 | |

**VENDIM**
**Nr. 120, datë 6.3.2024**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të neneve 6 e 18, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës (në vijim, Agjencia), si person juridik publik buxhetor në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e diasporës (në vijim, ministria), me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit, nga donacione dhe nga burime të tjera të ligjshme. Buxheti i Agjencisë përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë.

3. Misioni i Agjencisë është të kontribuojë, të nxisë e të promovojë rritjen e vlerave dhe të traditave më të mira kombëtare të diasporës.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË

Agjencia, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj, ka përgjegjësi të organizojë punën për:

a) përmirësimin e pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të saj, aty ku gjendet;

b) ofrimin e ndihmës për ruajtjen e gjuhës e të trashëgimisë kulturore kombëtare;

c) nxitjen e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;

ç) bashkëpunimin për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË

1. Agjencia organizohet në nivel qendror dhe ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Me qëllim përmbushjen e misionit e të përgjegjësive funksionale të saj, Agjencia:

a) merr masa për krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) zbaton politika dhe projekte që lidhen me diasporën;

c) ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës;

ç) mban lidhjet ndërmjet diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës;

d) bashkëpunon e koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë;

dh) ndihmon për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, të vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës;

e) informon diasporën për zhvillimet në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë;

ë) bashkëpunon me organizma vendas e ndërkombëtarë me fusha të ngjashme veprimtarie, me qëllim përthithjen e praktikave më të mira dhe krijimin e urave të bashkëpunimit.

3. Agjencia drejtohet nga titullari i Agjencisë, i cili organizon e drejton veprimtarinë e saj, përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet para ministrit.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Shërbimet e brendshme mbështetëse dhe funksionet e menaxhimit financiar realizohen nga strukturat përgjegjëse për këto funksione në ministri.

6. Marrëdhëniet e punës së titullarit të Agjencisë dhe nëpunësve të saj rregullohen sipas dispozitave të ligjit për nëpunësin civil, ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë

miratohet nga ministri, me propozim të titullarit të saj.

8. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e saj përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia Kombëtare e Diasporës", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

9. Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë sipas këtij vendimi, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë funksionale të Agjencisë Kombëtare të Diasporës si agjenci autonome do të vijojnë të ushtrohen sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

2. Buxheti i planifikuar për Agjencinë Kombëtare të Diasporës si agjenci autonome dhe të gjitha asetet e saj transferohen pranë Agjencisë së krijuar sipas këtij vendimi.

3. Nëpunësit civilë aktualë dhe punonjësit aktualë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, trajtohen përkatësisht sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil dhe Kodit të Punës, në rastin e mbylljes e të ristrukturimit të institucionit.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave, Departamenti i Administratës Publike dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 121, datë 6.3.2024

## PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa, e mëposhtme:

1. Pika 27, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"27. Vendimi i Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2011/72, "Për vendosjen e masave kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi", i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/1367, (CFSP) 2022/2086, (CFSP) 2023/159, (CFSP) 2024/421, sipas aneksit 27, bashkëlidhur këtij vendimi.".

2. Në aneksin 27, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2024/421, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian
AL seritë L
2024/421
30.1.2024

**VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2024/421**

**i 29 janarit 2024**

**për ndryshimin e Vendimit 2011/72/CFSP lidhur me masat kufizuese të drejtuara kundër disa personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Punëve të Jashtme dhe të Sigurisë,

Ndërsa:

(1) Më 31 janar 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/72/CFSP ([1]) në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi.

(2) Në bazë të rishikimit të Vendimit 2011/72/CFSP, masat kufizuese duhet të zgjaten deri më 31 janar 2025 dhe, në aneksin e atij vendimi, shënimet për tre persona duhet të fshihen.

(3) Vendimi 2011/72/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Vendimi 2011/72/CFSP ndryshohet si më poshtë:

(1) Neni 5 zëvendësohet si vijon:

'Neni 5

1. Ky vendim do të zbatohet deri më 31 janar 2025.

2. Ky vendim do të mbahet në shqyrtim të vazhdueshëm. Ai mund të rinovohet ose ndryshohet, sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tij nuk janë përmbushur.';

(2) Shtojca ndryshohet në përputhje me aneksin e këtij vendimi.

*Neni 2*

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, më 29 janar 2024

*Për Këshillin*
*Presidenti*
H. LAHBIB

([1]) Vendimi i Këshillit 2011/72/CFSP i 31 janarit 2011 në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Tunizi (OJ L 28, 2.2.2011, f. 62).

*ANEKS*

Në seksionet A dhe B të Aneksit të Vendimit 2011/72/CFSP, shënimet për personat e mëposhtëm fshihen:

14. Samira Bent Mohamed Ben Rhouma TRABELSI;

26. Dorsaf Bent Zine El Abidin Ben Haj Hamda BEN ALI;

27. Sirine (Cyrine) Bent Zine El Abidine Ben Haj Hamda BEN ALI.

Official Journal of the European Union
EN
L series
2024/421
30.1.2024

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2024/421**

**of 29 January 2024**

**amending Decision 2011/72/CFSP concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Tunisia**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 31 January 2011, the Council adopted Decision 2011/72/CFSP [1] concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Tunisia.

(2) On the basis of a review of Decision 2011/72/CFSP, the restrictive measures should be extended until 31 January 2025 and, in the Annex to that Decision, the entries for three persons should be deleted.

(3) Decision 2011/72/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

Decision 2011/72/CFSP is amended as follows:

(1) Article 5 is replaced by the following:

'*Article 5*

1. This Decision shall apply until 31 January 2025.

2. This Decision shall be kept under constant review. It may be renewed or amended, as appropriate, if the Council deems that its objectives have not been met.';

(2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 29 January 2024.

*For the Council*
*The President*
H. LAHBIB

(1) Council Decision 2011/72/CFSP of 31 January 2011 concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Tunisia (OJ L 28, 2.2.2011, p. 62).

*ANNEX*

In sections A and B of the Annex to Decision 2011/72/CFSP, the entries for the following persons are deleted:

14. Samira Bent Mohamed Ben Rhouma TRABELSI;

26. Dorsaf Bent Zine El Abidine Ben Haj Hamda BEN ALI;

27. Sirine (Cyrine) Bent Zine El Abidine Ben Haj Hamda BEN ALI.

**VENDIM**
**Nr. 122, datë 6.3.2024**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 173, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË PËRKOHSHME SHTETASVE UKRAINAS, PERSONAVE PA SHTETËSI DHE PERSONAVE QË KANË FITUAR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË UKRAINË, ME VENDQËNDRIM TË PËRKOHSHËM OSE TË PËRHERSHËM NË UKRAINË, SI DHE PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË KËRKUESVE TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3/2, të vendimit nr. 173, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare", të ndryshuar, shtohet pika 3/3, me këtë përmbajtje:

"3/3. Me përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 3/2 të këtij vendimi, personave që ndodhen ende në territorin e Republikës së Shqipërisë u shtyhet qëndrimi deri në datën 17.9.2024.".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 124, datë 6.3.2024**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 169, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT TË HYRJES DHE QËNDRIMIT TË SHTETASVE TË UKRAINËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 169, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, togfjalëshi "... 2 (dy) vjet ..." zëvendësohet me "... 3 (tre) vjet ...".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 128, datë 6.3.2024**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 112, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE 'DOKTOR' DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË 'PROFESOR I ASOCIUAR' DHE 'PROFESOR'", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, e 79, pika 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin

shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 3, fjalët "... përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar ..." zëvendësohen me "... përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë brenda vendit dhe udhëheqjet/bashkudhëheqjet që ndjek në institucionet e arsimit të lartë brenda vendit ose vendet anëtare të OECD-së, BE-së ose G-20-ës ku ai është i angazhuar ...".

b) Shkronja "b", e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jetë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI), ku është së paku, autor i dytë.".

c) Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me këtë përmbajtje:

"6/1. Bëjnë përjashtim nga shkronjat "a" dhe "b", të pikës 6, të këtij kreu, personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e arteve.

Kriteret bazë që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit janë:

a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, së paku, 3 (tri) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres).

b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore në fushën e krijimtarisë artistike, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar në revistë shkencore jashtë vendit, ku, së paku, të jetë autor i dytë.

6/2. Bëjnë përjashtim nga shkronjat "a" dhe "b", të pikës 6, të këtij kreu, personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Kriteret bazë që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit janë:

a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, së paku, 3 (tri) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres).

b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar në revistë shkencore jashtë vendit, ku, së paku, të jetë autor i dytë.".

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja "b", e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë)-vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje.

Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se pesë vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 8 (tetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.6 vite kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor".".

b) Shkronja "a", e pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimi te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).".

c) Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 dhe 5/2, me këtë përmbajtje:

"5/1. Bëjnë përjashtim nga shkronjat "a" dhe "b", të pikës 5, të këtij kreu, personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të

veçantë, me veprimtari në fushën e arteve.

Personeli akademik në fushën e arteve, që aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", zhvillon veprimtari kërkimore shkencore në fushën e krijimtarisë artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

a) Për kompozitorët, krijime të veprave të luajtura në skena që përfshijnë formën e sonatës ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë) ose vokalo-sinfonike.

b) Për instrumentistët, interpretime vepër/a solistike në formën e sonatës ose ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë).

c) Për këngëtarët lirikë, interpretime në rol kryesor në opera.

ç) Për dirigjentët, drejtim në skenë vepra sinfonike, ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë), vokalo-sinfonike ose opera.

d) Për aktorët, interpretime në role kryesore në teatër ose në film.

dh) Për regjisorët, vendosje në skenë të veprave teatrore, filmike, ose televizive.

e) Për skenografët/kostumografët, vendosja në skenë e shfaqjeve teatrore, televizive, operistike/balet ose në film artistik.

ë) Për krijuesit e arteve pamore dhe të aplikuara, hapja e ekspozitës personale, krijimi i veprave publike monumentale ose perfomancë artistike pamore në arenën kombëtare.

f) Për koreografët, vendosje në skenë vepre baleti ose performancë në televizion.

g) Për balerinët, interpretime në role kryesore në skenë në balet ose të performancës në televizion.

Secila nga kategoritë e përcaktuara në këtë pikë duhet të ketë marrë pjesë, së paku, në 5 (pesë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku, së paku, 2 (dy) nga veprat të jenë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezone).

Vepra/performanca të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak dhe të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse profesionale.

5/2. Bëjnë përjashtim nga shkronjat "a" dhe "b", të pikës 5, të këtij kreu, personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Personeli akademik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, që aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës dhe udhëheqjes ushtarake, pjesëmarrje në veprimtari trajnuese dhe aktivitete akademike, kërkimore-shkencore, e cila reflektohet në realizimin e 2 (dy) prej detyrimeve të mëposhtme:

a) Të ketë botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, nga të cilët, të paktën, 3 (tre) duhet të jenë në revista shkencore brenda vendit, si autor i parë, dhe 2 (dy) në revista shkencore ndërkombëtare, si autor i dytë ose bashkautor.

b) Të ketë realizuar si autor i parë, së paku, 2 (dy) referime, nga të cilat, së paku 1 (një) është mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të OECD-së, BE-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në *"Proceedings",* të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

c) Të ketë marrë pjesë, së paku, në 3 (tri) misione/operacione afatshkurtra, stërvitje, kurse të nivelit të lartë ushtarak, nga ku së paku në 1 (një) prej tyre të ketë qenë në rolin e drejtuesit.

ç) Të ketë përfaqësuar vendin në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, të paktën 1 (një) herë me kohëzgjatje jo pak se 1 (një) vit në struktura, shtabe apo përfaqësi jashtë vendit të nivelit të lartë.".

ç) Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

i. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 5, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:".

ii. Nënndarja "ii", e shkronjës "b", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë

citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).”.

iii. Nënndarja “ii”, e shkronjës “c”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus,* me indikatorë citimi, CiteScore ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).”.

d) Shkronja “a”, e pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator (JCI).”.*

3. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë)-vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”.

Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 (tetë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 (dymbëdhjetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.5 vitesh kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”.

c) Si rregull, të ketë udhëhequr ose bashkudhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata. Bashkudhëheqja duhet të jetë me personel akademik të kategorisë “Profesor”, me IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe. Në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, duhet të ketë udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar, *ndërsa kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit.”.*

b) Shkronja “a”, e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).”.

c) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 4, të këtij kreu, personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e arteve.

Personeli akademik në fushën e arteve, që aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor” duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij artistike-kërkimore-shkencore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

a) Për kompozitorët, krijime të veprave të luajtura në skena që përfshijnë formën e sonatës ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë) ose vokalo-sinfonike.

b) Për instrumentistët, interpretime vepre/ash solistike në formën e sonatës ose ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë).

c) Për këngëtarët lirikë, interpretime në rol kryesor në opera.

ç) Për dirigjentët, drejtim në skenë për vepra sinfonike, ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë), vokalo- sinfonike ose opera.

d) Për aktorët, interpretime në role kryesore në teatër ose në film.

dh) Për regjisorët, vendosje në skenë të veprave teatrore, filmike ose televizive.

e) Për skenografët/kostumografët, vendosja në skenë e shfaqjeve teatrore, televizive, operistike/balet ose në film artistik.

ë) Për krijuesit e arteve pamore dhe të aplikuara, hapja e ekspozitës personale, krijimi i veprave publike monumentale ose performancë artistike pamore, në arenën kombëtare.

f) Për koreografët, vendosje në skenë vepre baleti ose performancë në televizion.

g) Për balerinët, interpretime në role kryesore në skenë në balet ose të performancës në televizion.

Secila nga kategoritë e përcaktuara në këtë pikë duhet të kenë marrë pjesë, së paku, në 7 (shtatë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku, së paku, 3 (tri) nga veprat të jenë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në veprimtari ndërkombëtare, (festival, sezone).

Vepra/performanca të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak dhe të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse profesionale.

4/2. Personeli akademik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, që aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës dhe udhëheqjes ushtarake, pjesëmarrje në veprimtari trajnuese dhe aktivitete akademike, kërkimore-shkencore, e cila reflektohet në realizimin e, të paktën, 2 (dy) nga detyrimet e mëposhtme:

a) Të ketë botuar 5 (pesë) artikuj shkencorë brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, nga të cilët, të paktën, 3 (tre) duhet të jenë në revista shkencore brenda vendit, si autor i parë, dhe 2 (dy) në revista shkencore ndërkombëtare.

Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 3 (tre) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.

b) Të ketë realizuar si autor i parë, së paku, 3 (tri) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor.

c) Të ketë botuar si autor i parë ose bashkautor jo më pak se 3 (tri) vepra të karakterit kërkimor, shkencor ose mësimor të llojit tekste mësimore, manuale, doktrina ose dokumente të tjera të nivelit strategjik.

ç) Të ketë marrë pjesë, së paku, në 4 (katër) misione/operacione afatshkurtra, stërvitje, kurse të nivelit të lartë ushtarak etj., ku, së paku, në 2 (dy) prej tyre të ketë qenë në rolin e drejtuesit.".

ç) Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

i. Nënndarja "ii", e shkronjës "b", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus,* me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).".

ii. Nënndarja "ii", e shkronjës "c", të pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).".

d) Paragrafi i parë dhe shkronja "a", e pikës 7, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"7. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 6, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:

a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *Scimago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit te *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI);".

4. Në kreun V bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

*"7/1. Për* personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon *deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027,* për titullin akademik

"Profesor", *kriteri i shkronjës "c", të pikës 3, të kreut III, konsiderohet i plotësuar nëse* ka udhëhequr/bashkudhëhequr, të *paktën, 1 (një) doktoratë, të përfunduar*.

*Ndërsa,* në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, *kriteri i shkronjës "c", të pikës 3, të kreut III, konsiderohet i plotësuar nëse* kandidati është duke udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë dhe duhet të përmbushë edhe një nga kushtet e mëposhtme:

i. Të ketë pasur ose ka rolin e drejtuesit në një projekt ndërkombëtar;

ii. Të ketë dhënë ose jep mësim në një program në gjuhë të huaj në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht apo italisht;

iii. Të ketë përfunduar me sukses së paku të gjitha detyrimet e vitit të dytë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të doktoratës, të kandidatit doktorant që ka në udhëheqje/bashkudhëheqje të doktoratës.".

b) Pika 9 shfuqizohet.

c) Pas pikës 9 shtohen pikat 9/1, 9/2 dhe 9/3, me këtë përmbajtje:

"9/1. Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e gradës shkencore ose titujve akademikë dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" ose Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik e mbyllin procedurën për marrjen e gradës shkencore ose titullit akademik, sipas kritereve të legjislacionit në fuqi, në momentin e dorëzimit të dosjes pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

9/2. Bën përjashtim nga parashikimet e shkronjës "b", të pikës 3, të kreut III, personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë me status të veçantë, me veprimtari në fushën e arteve, që zotëron aktualisht titullin akademik "Profesor i asociuar", i cili është përjashtuar nga detyrimi i përmbushjes së kriterit të fitimit të gradës shkencore "Doktor", por që ka qenë titullar lënde, për një periudhë 5 (pesë)-vjeçare me kohë të plotë, ndërsa koha e pjesshme si titullar lënde pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar", konvertohet me kohë të plotë, me një koeficient 1.5.

9/3. Komandanti i Akademisë se Forcave të Armatosura, i cili mban së paku gradën "Gjeneral brigade", vetëm për efekt akreditimi institucional dhe të programeve të AFA, për një periudhë 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është njëkohësisht edhe Rektor i Akademisë së Forcave të Armatosura.".

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 129, datë 6.3.2024

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 99, DATË 27.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 25, 70 e 71, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar" zëvendësohet me "Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar" dhe akronimi "DPAP" zëvendësohet me "AKAP".

2. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë" zëvendësohet me "Ministria e Arsimit dhe Sportit".

3. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) nivel qendror, nëpërmjet agjencisë kombëtare;”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. AKAP-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e agjencisë kombëtare dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe lirohet nga ministri. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga 1 (një) zëvendësdrejtor i përgjithshëm, i cili emërohet me të njëjtat procedura si drejtori i përgjithshëm.”.

c) Në pikën 6, fjalët “... drejtorisë së përgjithshme në nivel qendror ...” zëvendësohen me “... agjencisë kombëtare ...”.

ç) Në pikën 8, fjalët “Drejtoria qendrore ...” zëvendësohen me “Agjencia kombëtare ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 130, datë 6.3.2024**

## PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2024 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri “Transfertë në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), të përdoret për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, të bimëve mjekësore dhe aromatike dhe të prodhimeve blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;

b) mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave, për uljen e kostos për naftën që përdoret, për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;

ç) mbështetjen e formave të kooperimit në bujqësi.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1 Bujqësia dhe blegtoria

a) pagesa në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB)”;

b) pagesa në vlerën deri në 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”;

c) mbarështim i bletarisë në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “grup fermerësh” ose “SHBB”.

ç) pagesa në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 5 (pesë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

d) pagesë për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/ha, për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha.

Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

dh) fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë;

iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.

2.2 Mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi

2.2.1 Mbështetje për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 1 251 600 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë e një milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

2.2.2 Subjektet përfitojnë pagesa për uljen e kostos për naftën, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kritereve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2.2.3 Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia respektive e naftës, për të cilën përllogaritet vlera e përfitimit, janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Çmimi referencë për naftën llogaritet nga çmimi i publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimit Publik (rubrika "Të dhëna për karburantet"), me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2.2.4 Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

ii. sipërfaqja totale për të cilën aplikohet duhet të jetë jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.2.5 Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet me vetëdeklarim.

2.2.6 Përfitimi për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

i. deri në 100% të vlerës, për fermerët/aplikantët me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përllogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "grup fermerësh" ose "SHBB".

2.2.7 Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet pas kalimit të pagesës te subjektet përfituese:

i. për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me vlerën e përfituar, e cila të jetë jo më e madhe se 20%;

ii. në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

2.2.8 Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes për naftën për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20%, sipas përcaktimeve të nënpikës 2.2.7, nënndarja "i", më sipër, ose me deklarime/dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave

mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

3. Për masat mbështetëse sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të nënpikës 2.1 dhe të nënpikës 2.2, kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Në rastet e shtesave/alokimeve eventuale të fondit, vlera e financimit që përfitohet nuk mund të jetë më e madhe se kufiri për masën përkatëse, i përcaktuar në këtë vendim.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim aplikantët me status "grup fermerësh" dhe "SHBB", të cilët përfitojnë vlerën maksimale të financimit të parashikuar në këtë vendim, edhe kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse.

4. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët individualë, grupet e fermerëve, personat fizikë, personat juridikë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

5. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Financave.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKS 1
KULTURA BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT, NORMATIVAT E KONSUMIT TË NAFTËS, SASIA E NAFTËS DHE VLERA QË PËRFITOHET

| Nr./Kodi | Kultura bujqësore/ grup kulturash | Normativa e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara | Sasia e naftës që përfitohet* | Vlera që përfitohet | Specifikime |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Litra/ha | Litra/ha | Lekë/ha | |
| **A** | **Bimë arash** | | | | |
| A.1 | Grupi 1 | 190 | 97 | **18,789** | Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum) |
| A.2 | Grupi 2 | 130 | 66 | **12,784** | Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk) |
| A.3 | Grupi 3 | 90 | 46 | **8,910** | Foragjere shumëvjeçare, bimë aromatike-mjekësore |
| **B** | **Dru frutorë** | | | | |
| B.1 | Mollë | 190 | 97 | **18,789** | |
| B.2 | Dru frutorë të tjera | 160 | 82 | **15,883** | Të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta |
| B.3 | Arrorë | 140 | 72 | **13,946** | Arra, bajame, lajthi dhe gështenja (të kultivuara) |
| B.4 | Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrorë | 170 | 87 | **16,852** | Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arrore |
| **C** | **Perime** | | | | |
| C.1 | Perime fushe sezoni 1 | 150 | 77 | **14,915** | Të gjitha llojet e perimeve, përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe |
| C.2 | Perime serre, sezoni 1 | 170 | 87 | **16,852** | Të gjitha llojet e perimeve, përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe |

**** Nga çmimi i naftës, zbriten:***
- akciza 38.8 lekë/L
- taksa e qarkullimit 27 lekë/L
- taksa e karbonit 3 lekë/L

-----------------------------------------------

Nën total 68,8 lekë/L
TVSH respektive (20%) 13,76 lekë/L

-----------------------------------------------

**TOTALI 82,56 lekë/L**
***** Koeficienti i përfitimit të naftës ndaj normativës = 82,56 lekë/161.4[1] *100 = 51%***

[1] Çmimi referencë për naftën për vitin 2024 është 161.4 lekë/litër (pa TVSH), ndërsa me TVSH 193,7 lekë/litër.

**VENDIM**
**Nr. 131, datë 6.3.2024**

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË "INVESTITOR NË STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE, STATUS SPECIAL" APLIKUESIT "KLAIS" SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special" aplikuesit "KLAIS", sh.p.k.
2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për turizmin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 132, datë 6.3.2024**

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (në vijim "Agjencia"), si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin (në vijim "ministri"), me seli në Tiranë.
2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi. Buxheti i Agjencisë përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për mjedisin.
3. Agjencia ka si mision të sigurojë:

a) koordinimin, monitorimin dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore (NJQV), institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë në menaxhimin e integruar të mbetjeve, me qëllim kalimin e këtij sektori në ekonomi qarkulluese;

b) promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve për zhvillimin gradual të grumbullimit përmes ndarjes në burim e riciklimit në shkallë të gjerë dhe monitorimin e implementimit të standardeve dhe edukimin mjedisor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim dhe dispozitat në ligjin përkatës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE

Agjencia ka këto përgjegjësi funksionale:

a) të koordinojë punën me institucionet e administratës publike, në nivel qendror e vendor, partnerët ndërkombëtarë, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e standardeve në menaxhimin efikas të integruar të mbetjeve, planifikimin territorial në infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre;

b) të organizojë punën për edukimin mjedisor, promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve për zhvillimin gradual të grumbullimit përmes ndarjes në burim e riciklimit në shkallë të gjerë.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE

1. Agjencia e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.
2. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e saj, përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet para ministrit.
3. Drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri. Drejtori i përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

ç) të ketë përvojë pune të paktën 7 (shtatë) vjet në profesion;

d) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

4. Drejtori i përgjithshëm shkarkohet nga detyra, kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;

c) nuk përmbush objektivat strategjikë të institucionit;

ç) ka performancë të dobët në ushtrimin e detyrës.

5. Drejtori i përgjithshëm lirohet nga detyra, kur:

a) plotëson kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) ristrukturohet institucioni;

ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

d) jep dorëheqjen nga detyra.

6. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, të nëpunësve, si dhe të punonjësve administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

7. Agjencia, në zbatim të misionit, fushave të përgjegjësisë dhe përgjegjësive funksionale të saj, kryen këto detyra:

a) Ndjek zbatimin e masterplanit kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe strategjisë sektoriale për mbetjet;

b) Mbështet ministrinë përgjegjëse për mjedisin për të përgatitur propozimet për ndryshime dhe përmirësime të kuadrit ligjor e nënligjor, që lidhet me menaxhimin e integruar të mbetjeve;

c) Krijon e monitoron zbatimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në nivel rajonal dhe vendor;

ç) Koordinon, monitoron dhe ndjek zbatimin e planeve, programeve dhe projekteve, që lidhen me infrastrukturën për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

d) Koordinon së bashku me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë planifikimin e nevojave për investime, bazuar në politikat e qeverisë dhe në masterplanin kombëtar sektorial të menaxhimit të integruar të mbetjeve;

dh) Koordinon nga pikëpamja teknike projektet për menaxhimin e integruar të mbetjeve të financuara nga buxheti i shtetit apo burime të tjera financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim garantimin e rregullave/procedurave teknike;

e) Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e politikave strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve;

ë) Planifikon nevojat për trajnime dhe koordinon punën për realizimin e tyre;

f) Koordinon e asiston ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për nismat për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Agjencia asiston, përveçse sa më lart, por pa u kufizuar në qendrat e transferimit, stacionet e riciklimit dhe të kompostimit;

g) Koordinon punën për zbatimin e programit të edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

gj) Monitoron zbatimin e udhërrëfyesit ("*roadmap*") për kalimin nga ekonomia lineare drejt ekonomisë qarkulluese;

h) Ushtron çdo detyrë tjetër të përcaktuar në akte ligjore e nënligjore.

8. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

9. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të saj.

10. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e Agjencisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: "Republika e Shqipërisë, Ministria (emri i ministrisë përgjegjëse), Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve", në përputhje me përcaktimet e

vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

11. Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 698 (4654), datë 31.10.2023, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Emilian Kaloshi, i datëlindjes 14.9.1978, me atësi Enver dhe me amësi Shpresa, lindur dhe banues në Tiranë, si dhe caktimin si kujdestar të tij institucionin e përkujdesjes "Shtëpia Rregulltare e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë – Kontemplative".

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 352 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/03/12 15:13:37 +02'00'
4838522024031215132673031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*